



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R

Nr. 279 DATË, 28. 01. 2008

PËR

**MIRATIMIN E ORGANIKËS SË PROKURORËVE NË ZYRËN E
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

Me synim, miratimin e organikës së prokurorëve sipas hallkave të strukturës në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm;

Në mbështetje, të nenit 118 e vijues të Kushtetutës, të nenin 8 pika 2 germa "ç" © vijues të ligjit nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr. 9102 datë 10. 07. 2003, si dhe të urdhrit nr. __ , datë 28. 01. 2008 "Për strukturën, organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm",

URDHËROJ:

**I. MIRATIMI I ORGANIKËS SË PROKURORËVE NË ZYRËN E
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

1. Organika e prokurorëve sipas hallkave të strukturës në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të jetë, si më poshtë:

- 1.1 Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale** e përbërë nga 7 (shtatë) prokurorë;
- 1.2 Drejtoria Gjyqësore** e përbërë nga 4 (katër) prokurorë;
- 1.3 Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore** e përbërë nga 4 (katër) prokurorë;
- 1.4 Sektori i Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative** i përbërë nga 1 (një) prokurorë;

**1.5 Sektori i Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Mbikëqyrjes
së Vuajtjes së Dënimit** i përbërë nga 1 (një) prokurorë.

II. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

1. Me këtë urdhër të njihen prokurorët dhe drejtuesit - prokuror - të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore e kësaj Zyre.

3. Çdo akt normativ që bie në kundërshtim me këtë urdhër, në pjesët që miraton organikën e prokurorëve të kësaj Zyre, shfuqizohet.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

INA RAMA

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized 'I' and 'R' followed by a horizontal line and a small flourish.

